URDHËR
Nr. 223, datë 6.3.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E GJERMANISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:
a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
b) zogjve 24-orësh;
c) shpendëve dekorativë;
ç) materialit biologjik të shpendëve;
d) vezëve të shpendëve;
dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.
Nga shteti i Gjermanisë, sipas tabelës së mëposhtme:

**Ndarja administrative e nivelit 1*	*Ndarja administrative e nivelit 2*	*Ndarja administrative e nivelit 3*
Mecklenburg-Vorpommern	Ludwigslust-Parchim	Parchimer Umland*
Bayern	Augsburg (Kreisfreie Stadt)	Augsburg*
Bayern	Garmisch-Partenkirchen	Ohlstadt*
Rheinland-Pfalz	Rhein-Pfalz-Kreis	Dannstadt-Schauernheim*
Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Altenpleen*
Mecklenburg-Vorpommern	Rostock (Kreisfreie Stadt)	Rostock*
Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Stralsund*
Niedersachsen	Oldenburg	Hude*
Baden-Württemberg	Schwäbisch Hall	Ilshofen-Vellberg*
Niedersachsen	Wittmund	Holtriem*
Bayern	Eichstätt	Kösching*
Niedersachsen	Grafschaft Bentheim	Emlichheim*
Schleswig-Holstein	Plön	Probstei*
Niedersachsen	Leer	Jemgum*
Niedersachsen	Aurich	Aurich*
Niedersachsen	Friesland	Wangerland*
Niedersachsen	Aurich	Hinte*
Niedersachsen	**Emsland**	**Emsbüren***
Brandenburg	**Oberhavel**	**Zehdenick***
Mecklenburg-Vorpommern	**Vorpommern-Greifswald**	**Landhagen***
Schleswig-Holstein	**Schleswig-Flensburg**	**Süderbrarup***
Sachsen	**Leipzig**	**Grimma***

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24 orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të

shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 206, datë 4.3.2025, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë", shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj